PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 22.07.2026

Sot në sallën e KB Devoll zhvillohet mbledhja e rradhës sipas njoftimit të datës 17.07.2026.

Të pranishëm në sallë:Ilir Hoxha, Valbona Spaho, Eroldi Begolli, Oljana Comka, Kledi Cenkolli, Festim Kaso, Oliver Mulla, Lindita Cokani, Esmeralda Medolli, Ermena Xhaci, Vladimir Kello, Alfredi Gjata.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1 "Miratimi i rendit të ditës".

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Ka ndonjë nga këshilltarët konflikt interesi?

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Asnjë nga këshilltarët nuk ka konflikt interesi.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2, "Miratimi i procesverbalit të datës 30.06.2026".

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3, Projekt-Vendim Nr.47 Datë 21.05.2026 " Për rishqyrtim "Për dhënien me qira të sipërfaqes 50 HA në ngastrën me kod kadastral KO02 00 019 në ekonominë kullosore "Bilisht" (Për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme).

Alfredi Gjata: Këto Pv për rishqyrtim në rendin e ditës nuk janë miratuar nga Prefektura pasi kishin nevojë për votim me shumicë të cilësuar, kështu që do rifuten përsëri pa ndryshme vetëm për procedurë votimi,

Eroldi Begolli: Edhe pse nuk kanë ndryshime në përmbajtje këto Pv, nuk duhet te ishin miratuar dhe zbardhur vendime për sa kohë nuk kanë marrë votat e duhura. Ligji e përcakton për një sërë projektvendimesh të cilat duhet të votohen nga shumicë e cilësuar. Nuk mund te rifutet për sa kohë ke nxjerrë një vendim.

Eduard Duro: Rishikimi është vetëm për procedurë votimi.

Eroldi Begolli: Si fillim duhet bërë rrëzimi i vendimit aktual dhe pastaj të dalë një vendim i ri. Nuk mund të lesh 2 vendime në fuqi për të njëjtin Projekt-Vendim.

Eduard Duro: U bënë disa mbledhje që Këshilli Bashkiak mezi mbledh kuorumin, dhe ne duhet të pezullojmë gjithë punën e institucionit.

Eroldi Begolli: Kjo është cështje tjetër, procedura është procedurë. Nëse këshilltarët nuk marrin pjesë është detyrë e Kryetarit të Këshillit bashkë me kryesinë të marrin masa.
Problemi është që kjo kërkon një procedurë.

Alfredi Gjata: Në rregull, ne do të shprehemi tek vendimi i rradhës për shfuqizimin e Vendimit aktual dhe zëvëndësimin me këtë që është për miratim sot.

Në sallë vjen Këshilltarja Albana Skoti. (Bëhen 13 këshilltarë.)

Eduard Duro: Këtu kemi dhe ndryshimin në buxhet, nëse nuk dorëzohet deri në datën 24, është I pavlefshëm.

Eroldi Begolli: Afati i dorëzimit është nga Janari deri në Qershor. Mund të bëhët dhe më parë, ska pse lihet moment të fundit.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4, Projekt-Vendim Nr. 53 Datë 24.06.2026 "Për rishqyrtim " Për miratimin e projektit te pare te Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5, Projekt-Vendim Nr.55 Datë 24.06.2026 "Për rishqyrtim "Për rishikimin e buxhetit të vitit 2026."

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 6, Projekt-Vendim Nr.56 Datë 24.06.2026 "Për rishqyrtim "Për miratimin e bashkëortakërisë nëpërmjet dhurimit të një pjese të kuotës nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ALBEDO Solar SHPK dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes për transferimin e kuotave."

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 7, Projekt-Vendim Nr.57 Datë 16.07.2026 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok ndihmën ekonomike për muajin Qershor 2026.

Nuk ka diskutime për këtë Projekt-Vendim.

Hapet votimi: 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 8, Projekt-Vendim Nr.58 Datë 16.07.2022 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 në nivel programi.

Nuk ka diskutime për këtë Projekt-Vendim.

Hapet votimi: 13 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 9, Projekt-Vendim Nr.59 Datë 16.07.2026 "Për shtesën në buxhet sipas shkresës Nr.11214/3 Prot datë 06.07.2026 nga ministria e financave mbi zbatimin e aktit normativ Nr.02 datë 30.06.2026.

Nuk ka diskutime për këtë Projekt-Vendim.

Hapet votimi: 12 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 10 dhe 12, Projekt-Vendim Nr.60 Datë 16.07.2026 "Për miratimin e planit social vendor të Bashkisë Devoll për vitin 2027-2030." Dhe

12.Projekt-Vendim Nr.62 Datë 17.07.2026 "Për miratimin e planit të menaxhimit të pyjeve bashkiak të ekonomisë pyjore Qafa e Zvezdës-Trestenik."

Të dyja këto ProjektVendime do të shtyhen për në Shtator, pasi për Pv Nr.60, pardje na konfirmohet nga performanca që ky plan nuk vlen pasi është për vitin 2027.

Gjithashtu edhe për PV Nr.62 vlen e njëjta gjë.

Hapet votimi për shtyrjen e këtyre dy Pv.
13 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 9, Projekt-Vendim Nr.61 Datë 17.07.2026 "Për dhënien e titullit qytetar nderi për Z.Zamir Dule."

Eliverta Pavliqoti: Komisioni ka marrë në shqyrtim dokumentacionin dhe është shprehur me procesverbalin që ju është paraqitur.

Këshilltarja Lindita Cokani lexon një biografi të Z.Zamir Dule, pavarësisht së ka dorëzuar kërkesën bashkë me të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm.

Vladimir Kello: Në bazë të propozimit që është bërë për të ndjerin Z.Zamir Dule janë përcaktuar 6 arsye dhe vlera themelore dhe asnjëra nga këto nuk është me vend për sa I përket dhënies të këtij titulli sepse në bazë të ligjit personat që kanë kontribut të shquar në bashkinë Devoll ose kanë arritje të vecanta në fusha si : Zhvillimi I komunitetit , arsimtar, kultura, shkenca dhe sporti, humanizmi dhe shërbimi ndaj qytetarëve të bashkisë, promovimi I emrit dhe vlerave të Devolli. Për respektin që kam , për mendimin tim nga shoqata e gazetarëve, të propozohet Hero i popullit. Unë kështu e gjykoj të shpallet.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër , 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Për sa i përket një problem në lidhje me publikimin e vendimeve në faqen ëeb, kërkojmë një zgjidhje nga administrata për të vazhduar procesin e publikimit nga ana teknike si është bërë për vite me rradhë duke qënë së Sekretari I Këshillit Bashkiak nuk është në profesion IT, dhe ne nuk kemi Sekretariat ku të kishim dhe një IT të brendshëm .

Eduard Duro: Le të hapen kredincialet në emër të Sekretarit të Këshillit, dhe nga ana teknike të administrohet dhe publikohen nga IT e Bashkisë.

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Sekretari I Këshillit

Kostandina Braholli

KRYETARI I KESHILLIT

ALFREDI GJATA